



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

# RR E G U L L O R E

Nr.20, datë 28.12.2015

Për

**“Procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”**

**KREU**  
**I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave mbi të cilat AKEP bazohet në përputhje me detyrimet ligjore, për procedurën që ndjek dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP, për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe atë postar.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

Qëllimi i rregullores është garantimi i plotësimit të nevojave për financimin dhe buxhetin e AKEP për ushtrimin e veprimtarisë si organ kompetent në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, nëpërmjet pagesave për mbikëqyrjen e tregjeve respective, që duhet të kryejnë sipërmarrësit dhe ofruesit e shërbimeve postare në përputhje me përcaktimet ligjore.

**Neni 3**  
**Baza Ligjore**

Nxjerrja e rregullores dhe dispozitat për normimin e procedurës dhe mënyrës së llogaritjes të nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të:

- a) komunikimeve elektronike, bazohen në:

Nenin 24, pikat 1 dhe 2 të nenit 117, pika 1.a) e nenit 119, të ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji 9918*);

- b) shërbimit postar, bazohet në:

Nenin 27 të ligjit nr.46/2015, datë 07.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” (*ligji 46/2015*).

**Neni 4**  
**Parimet e zbatueshme**

4.1 Pagesat vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut të shërbimit postar që duhet të paguajnë në AKEP sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimit dhe ofruesit e shërbimit postar, nuk duhet të deformatojnë konkurrencën apo krijojnë pengesa për hyrjen në treg të subjekteve të rinj të interesuar për të ushtruar aktivitet tregtar në tregjet respektive sipas përcaktimeve ligjore.

4.2 Pagesa për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbimit postar duhet të bëhet nga subjektet e përcaktuara ligjërisht, për të mbuluar në mënyrë të ndarë kostot administrative të AKEP, për ushtrimin e veprimtarisë si organ rregullator në secilën nga fushat referuese.

## **Neni 5**

### **Kufiri i nivelit të pagesës për mbikëqyrjen**

Pagesa vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe pagesa për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar, në çdo rast, për secilin sipërmarrës dhe ofrues të shërbimeve postare, nuk duhet të jetë më e lartë se niveli në përqindje mbi bazën e së ardhurës vjetore të realizuar në vitin kalendarik të mëparshëm, i përcaktuar vecanërisht në ligjin që rregullon marrëdhëniet në fushën e komunikimeve elektronike dhe ligjin për shërbimet postare.

## **KREU II**

### **DISPOZITA PROCEDURIALE**

## **Neni 6**

### **Dorëzimi i pasqyrave financiare dhe i bilancit vjetor**

6.1 Sipërmarrësit dhe ofruesit e shërbimeve postare, subjekt i detyrimit të pagesës për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimit postar, me qëllim vërtetimin e të ardhurës vjetore të realizuar nga veprimtaria në fushën përkatëse, brenda afatit të përcaktuar në këtë rregullore, depozitojnë në AKEP:

- a) Kopje të bilancit vjetor të depozituar në organin kompetent tatimor sipas legjislacionit në fuqi;
- b) Kopje të raportit të ekspertit kontabël të autorizuar, të depozituar në organin kompetent tatimor sipas legjislacionit në fuqi;
- c) Kopje të Pasqyrave financiare të audituara;
- ç) Kopje të Formularit të Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Fitimin sipas legjislacionit në fuqi;
- d) Deklaratën e subjektit mbi të ardhurën vjetore të vitit të mëparshëm, realizuar nga veprimtaria në fushën e komunikimeve elektronike dhe/ose të shërbimit postar.

6.2 Dokumentacioni i kërkuar për depozitim në AKEP sipas pikës 6.1 të këtij neni dërgohet nga subjekti, në rrugë elektronike në adresën elektronike të AKEP [info@akep.al](mailto:info@akep.al) dhe shkresore në adresën e njoftuar nga AKEP.

6.3 Afati i depozitimit në AKEP nga subjekti që mbart detyrimin, të dokumentacionit sipas pikës 6.1 të këtij neni, është i njëkohshëm me atë të përcaktuar për secilin rast në ligjin nr.9918, ligjin nr. 46/2015, si dhe legjislacionin tatimor në fuqi për depozitimin në organin tatimor të bilancit vjetor të subjektit.

6.4 Me qëllim llogaritjen dhe kryerjen e pagesës për mbikëqyrjen e tregut, brenda afatit ligjor të parashikuar, sipërmarrësit dhe ofruesit e shërbimit postar, jo më vonë se data 15 Mars e vitit korrent, depozitojnë në rrugë elektronike në adresën e AKEP [info@akep.al](mailto:info@akep.al) “Deklaratën paraprake mbi të ardhurën vjetore të realizuar nga veprimtaria në fushën e komunikimeve elektronike dhe/ose shërbimit postar për vitin e mëparshëm”.

6.5 E dhëna e deklaruar paraprakisht nga subjekti sipas këtij rregulli, duhet të përputhet me atë të pasqyruar në bilancin vjetor që dorëzohet në organin tatimor. Në rast mospërputhje subjekti deklarues mban përgjegjësi për pasojat dhe kryhen korrigjimet sipas parashikimeve ligjore për saktësinë e të dhënave të vetdeklaruara.

## **Neni 7**

### **Njoftimi i AKEP**

7.1 Çdo Sipërmarrës/subjekt që mbart detyrimin e pagesës së mbikëqyrjes së tregut sipas kësaj rregullore, ka detyrimin ligjor që edhe pa u njoftuar më parë nga AKEP-i, të depozitohë brenda afatit të përcaktuar në ligj dhe aktet në zbatim të tij, dokumentacionin sipas pikës 6.1 të nenit 6 të mësipërm.

7.2 Megjithatë, për t'u ardhur në ndihmë subjekteve për plotësimin e detyrimeve ligjore sa më sipër, AKEP brenda datës 15 Shkurt të vitit korrent, në rrugë elektronike dhe/ose shkresore njofton të gjitha subjektet që mbartin detyrimin e pagesës së mbikëqyrjes së tregut, për depozitimin në AKEP të :

- a) “Deklaratës paraprake mbi të ardhurën vjetore të realizuar nga veprimtaria në fushën e komunikimeve elektronike dhe/ose shërbimit postar për vitin e mëparshëm”;
- b) Dokumentacionit sipas pikës 6.1 të nenit 6 të kësaj rregullore.

## **Neni 8**

### **Llogaritja e nivelit të pagesës vjetore**

8.1 Llogaritja e nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar kryhet nga AKEP-i mbi bazën e formulës së përcaktuar në këtë rregullore dhe të dhënave që administron AKEP për të ardhurat e siguruara nga secili subjekt që mbart detyrimin e kësaj pagese, si dhe të shumës së shpenzimeve për mbulimin e kostove administrative të AKEP për vitin korrent për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe atë të shërbimit postar, të ndarë veças për secilin zë, sipas planit të shpenzimeve të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

8.2 Afati i llogaritjes nga struktura përgjegjëse e AKEP, të nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar, është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike pas datës së njoftuar për depozitimin nga subjekti që mbart detyrimin e pagesës së mbikëqyrjes së tregut, të dokumentacionit sipas pikës 6.1 të nenit 6 të kësaj rregullore.

8.3 Mos depozitimi i dokumentacionit sipas pikës 6.1 të mësipërme brenda afatit të parashikuar ligjërisht, nga subjektet që mbartin këtë detyrim sipas rregullores, nuk përbën pengesë që AKEP të veprojë për të llogaritur dhe përcaktuar kryesisht nivelin e pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut mbi bazën e informacionit që disponon dhe të dhënave historike për këtë qëllim.

## **Neni 9**

### **Faturimi dhe Pagesa**

9.1 AKEP, menjëherë me përcaktimin e nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe atij të shërbimit postar, në rrugë elektronike dhe shkresore i dërgon çdo subjekti (sipërmarrës/ofrues i shërbimit postar) faturën e pagesës për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe/ose mbikëqyrjes së tregut të shërbimit postar.

9.2 Subjekti që mbart detyrimin e kryerjes së pagesës së mbikëqyrjes sipas kësaj rregullore, me dërgimin e faturës nga AKEP, brenda 15 ditëve kalendarike pas datës së marrjes së saj, kryen pagesën e faturuar.

9.3 Pagesa e faturuar nga AKEP bëhet nga subjekti që mbart detyrimin e kryerjes së pagesës së mbikëqyrjes së tregut sipas kësaj rregullore, në llogaritë bankare të AKEP të specifikuara në faturën që i dërgohet.

### **KREU III DISPOZITA MATERIALE**

#### **Neni 10 Formula e llogaritjes së nivelit të pagesës vjetore**

10.1 Niveli i pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar përcaktohet në përqindje dhe është i barabartë respektivisht për secilin subjekt që mbart detyrimin e kësaj pagese:

- a) sipërmarrësit e komunikimeve elektronike;
- b) ofruesit e shërbimit postar.

10.2 Niveli i pagesës vjetore për mbikëqyrje të tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut të shërbimit postar, llogaritet nga struktura përgjegjëse në AKEP dhe raportohet në mbledhjen e rradhës të Këshillit Drejtues.

10.3 Niveli i pagesës vjetore do të jetë në çdo rast brenda kufirit prej 0.5% të së ardhurës vjetore të realizuar vitin e mëparshëm nga:

- a) sipërmarrësit e komunikimeve elektronike;
- b) ofruesit e shërbimit postar;

10.4 Niveli i pagesës vjetore për secilën nga pagesat për mbikëqyrjen e tregut, llogaritet me formulën:

$$NPV = \frac{KAdV}{AV} \times 100$$

NPV - Niveli i pagesës vjetore në përqindje (%) i veçantë sipas secilit rast, për mbikëqyrjen e tregut të:

- komunikimeve elektronike;
- shërbimit postar.

KAdV - Kosto administrative vjetore e AKEP e planifikuar për vitin korrent për mbikëqyrjen veças të secilit nga tregjet, që do të financohet respektivisht nga pagesat për mbikëqyrjen e tregut të:

- komunikimeve elektronike;
- shërbimit postar.

të përcaktuara në Planin vjetor të shpenzimeve të AKEP miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe planin e detajuar të shpenzimeve vjetore të miratuar nga Këshilli Drejtues.

AV - Shuma e të ardhurave vjetore të vitit të mëparshëm e realizuar veças nga veprimtaria në secilin nga tregjet prej:

- sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe/oseshërbime publike për komunikime elektronike;
- ofruesve të shërbimit postar.

#### **Neni 11**

## **Llogaritja e pagesës vjetore për Sipërmarrësit/subjektet**

11.1 Pagesa vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe tregun e shërbimit postar që duhet të kryejë çdo sipërmarrës dhe/ose ofrues i shërbimit postar për vitin korrent, llogaritet nga struktura përgjegjëse në AKEP sipas formulës:

$$PV = AVS \times NPV$$

PV - Pagesa vjetore që do të kryhet nga secili:

- sipërmarrësi për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike;
- ofrues i shërbimit postar për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar.

AVS - Të ardhurat vjetore sipas pasqyrave financiare vjetore të vitit të mëparshëm, të secilit:

- sipërmarrës të komunikimeve elektronike;
- ofrues të shërbimit postar.

NPV - Niveli i pagesës vjetore korrente, në përqindje (%), për mbikëqyrjen e tregut të:

- komunikimeve elektronike;
- shërbimit postar.

i llogaritur sipas formulës të përcaktuar në neni 10 të kësaj rregullore për mbulimin e kostove administrative të AKEP për mbikëqyrjen e secilit nga tregjet e mësipërcituar.

## **KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 12 Kundërvajtjet administrative**

12.1 Mos dorëzimi në AKEP i Bilancit vjetor dhe raportit të ekspertit kontabël nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, brenda afatit të përcaktuar në këtë rregullore, si dhe mos pagesa e plotë e shumës për mbikëqyrjen e tregut nga ana e sipërmarrësit, sipas faturës së dërguar nga AKEP në përputhje me këtë rregullore, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe janë të dënueshme sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

12.2 Mos dorëzimi në AKEP i pasqyrave financiare të audituara nga ofruesit e shërbimit postar, brenda afatit të përcaktuar në këtë rregullore, si dhe mos pagesa e plotë e shumës për mbikëqyrjen e tregut nga ana e ofruesit, sipas faturës së dërguar nga AKEP në përputhje me këtë rregullore, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe janë të dënueshme me gjobe sipas përcaktimeve të nenit 61/ viii/ii në ligjin nr. 46/2015 datë 7.05.2015 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 13 Shfuqizime**

Rregullore Nr. 20, datë 19.02.2010 mbi “Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” e ndryshuar, shfuqizohet.

**Neni 14**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi datë 01.01.2016 pas miratimit në mbledhjen e Këshillit Drejtues dhe publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Miratuar në mbledhjen e Këshillit Drejtues datë 28.12.2015



## **QËNDRIMI I AKEP PËR KOMENTET E DËRGUARA NË KËSHILLIM PUBLIK**

“Rregullore nr. 20, datë  
19.02.2010 mbi "Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve  
Elektronike dhe tregut të shërbimit postar”.



AKEP me VKD Nr. 2626, datë 29.10.2015, miratoi për këshillim publik dokumentin “Për disa shtesa dhe ndryshime në dokumentin Rregullore nr. 20, datë 19.02.2010 mbi "Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike -Këshillim Publik”

Në këtë dokument të publikuar në faqen zyrtare [www.akep.al](http://www.akep.al), AKEP kishte hartuar disa pyetje për të marrë opinionin e palëve të interesuara. Në përfundim të fazës së këshillimit publik në AKEP depozituan komentet:

1. (sipërmarrësi I) shkresa 9419 datë 27.11.2015, AKEP nr. Prot 2131 datë 1.12.2015 me objekt: Komentet e Albtelecom sh.a në lidhje me dokumentin e këshillimit publik "Për disa shtesa dhe ndryshime ne Rregullore nr.20 date 19.02.2010 "Mbi pagesat për mbikëqyrjen e tregut te komunikimeve elektronike" të ndryshuar.
2. (sipërmarrësi II) shkresa nr.1856 datë 30.11.2015 Nr.prot.2132 datë 2.12.2015 me objekt: Komente dhe propozime “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullore nr.20 datë 19.02.2010 “Mbi pagesat për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” të ndryshuar.
3. (sipërmarrësi III) sh.a, shkresa LRD 0156/ IK datë 27.11.2015, AKEP nr.prot 2131/1 datë 2.12.2015;

AKEP i falenderon të gjithë pjesëmarrsit për kontributet e dhëna në procesin e këshillimit publik.

Ky dokument përmban komentet e bëra me shkrim nga palët e interesuara dhe qëndrimin e AKEP mbi komentet.

Për orientim dokumenti është stukturuar në këtë mënyrë:

- pyetjet e hartuar nga AKEP në këshillim publik ;
- komentet/përgjigjet e secilit operator mbi këto pyetje, si dhe
- qëndrimin e mbajtur nga AKEP për komentet përkatëse

**1. A jeni dakort me ndërhyrjet në Regulloren Nr. 20, e ndrshuar, në lidhje me:**

**a) Afatet e përcaktuara në të;**

**b) Mënyrën e përlogaritjes së pagesave për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut të shërbimit postar.**

**Sipërmarrësi 1:**

Në lidhje me afatet e përcaktuara, sugjeron: njehësimin e të gjitha afateve të përcaktuara për procesin e pagesës së mbikëqyrjes së tregut të shërbimeve elektronike nga sipërmarrësit e këtij tregu me afatet e përcaktuara të propozuara në këtë dokument këshillimi për procesin e pagesave të mbikëqyrjes së tregut të shërbimit postar nga ofruesit e shërbimeve postare.

Shprehet për pamundësi efektive të sipërmarrësit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar në rregullore si pasqyrat financiare, kopje e vërtetimit të ekspertit kontabël të autorizuar, apo kopje të formularit të deklaramit dhe të pagesës së tatimit mbi fitimin brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

Në 2 vitet e fundit, pavarësisht vullnetit të mire të sipërmarrësit dhe gatishmerisë së tij të treguar në plotësimin brenda afateve të detyrimeve për raportim pranë AKEP, megjithë mbylljen e bilancit deri në 31 Mars të vitit kalendarik pasardhës, në asnjë rast, nga ekspertet kontabël të autorizuar sipërmarrësi shprehet se nuk ka qenë e mundur përgatitja e raportit të tyre brenda afatit të përcaktuar në rregulloren në fuqi, 31 Mars.

Sipërmarrësi është drejtuar zyrtarisht AKEP-it për të kërkuar kohë/shtyrje të afatit për depozitim të raportit të auditorëve, duke bërë kështu vetëm depozitim e pasqyrave të tij financiare (apo ngarkimin në modulën online), të cilat të vetme të pashoqëruara me raportin e ekspertëve nuk mund të konsiderohen të certifikuar.

Afati i propozuar/përcaktuar për ofruesit e shërbimit postar për depozitim e pasqyrave financiare, raportit të eksperteve, kopjes së formularit të deklaramit dhe të pagesës së tatimit mbi fitimin brenda datës 22 Prill të vitit pasardhës, në rast përcaktimi të njëjtë edhe për sipërmarrësit e tregut të komunikimeve elektronike i jep mundësi këtyre të fundit për raportimin brenda afateve të rregullores

a) Lidhur me afatin e Depozitimit të Pasqyrave Financiare nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të parashikuar në Nenin 6. pika 6.1 d) sugjeron njehësimin me afatin e parashikuar për ofruesit e shërbimeve postare brenda datës 22 Prill;

b) Lidhur me afatin e llogaritjes së pagesës së mbikëqyrjes nga AKEP për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të parashikuar në Nenin 7 , pika 7/I(a), sugjeron njehësimin me afatin e parashikuar për ofruesit e shërbimeve postare brenda datës 5 Maj;

- c) Lidhur me afatin e llogaritjes dhe faturimit të pagesës së mbikqyrjes nga AKEP për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të parashikuar në Nenin 8. pika 8.1. sugjeron njehsimin me afatin e parashikuar për ofruesit e shërbimeve postare brenda datës 6 Maj;
- d) Lidhur me afatin e dërgimit të fatures së pagesës për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike nga AKEP dhe afatin e kryerjes së pagesës nga sipërmarrësit e këtij tregu të parashikuar në Nenin 9 pika 9.1. sugjeron njehsimin me afatin e parashikuar/propozuar për ofruesit e shërbimeve postare, brenda datës 8 Maj për dërgimin e faturës dhe ndryshimin e afatit të parashikuar për kryerjen e pagesës nga sipërmarrësit e tregut të komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimit postar me përcaktimin sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Sipërmarrësi II:**

Afatet e llogaritjes së pagesës vjetore për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimit postar të jenë të njëjta.

### **Sipërmarrësi III**

Afati i depozitimit të informacionit on-line mbi të ardhurat si dhe dorëzimi i pasqyrave financiare dhe formularit të deklarimit të pagesës së tatim-fitimit të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike të saktësohet që në fjalinë e parë të nenit 6.1 se ky i fundit do të jetë data 31 mars e vitit pasardhës, si më poshtë:

#### **QËNDRIMI I AKEP;**

Në nenin 6 kemi reflektuar duke lehtëuar procedurat për dorëzimin e pasqyrave financiare dhe bilancit vjetor, sipas tekstit të Rregullores bashkëngjitur. Sqarojme se afatet e vendosura nga ligjet respective nuk mund të ndryshohen, por në nenin 7.2 të rregullores kemi parashikuar "...Megjithatë, për t'u ardhur në ndihmë subjekteve për plotësimin e detyrimeve ligjore sa më sipër, AKEP brenda datës 15 Shkurt të vitit korrent, në rrugë elektronike dhe/ose shkresore njofton të gjitha subjektet që mbartin detyrimin e pagesës së mbikqyrjes së tregut, për depozitimin në AKEP të :

- a) "Deklaratës paraprake mbi të ardhurën vjetore të realizuar nga veprimtaria në fushën e komunikimeve elektronike dhe/ose shërbimit postar për vitin e mëparshëm";

**b) Mënyrën e përlllogaritjes së pagesave për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut të shërbimit postar.**

### **Sipërmarrësi II**

Shprehet dakord me llogaritjen e pagesave për mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut të shërbimit postar.

### **Sipërmarrësi III**

Shprehet dakord me qëndrimin e AKEP.

## **QËNDRIMI I AKEP**

AKEP gjykon se afatet në rregullore janë përcaktuar në përputhje me Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Ligjin nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe merr në konsideratë komentin e sipërmarrësit.

### **2. A jeni dakort me mënyren e depozitimit të pasqyrave financiare në AKEP?**

#### **Sipërmarrësi II:**

Në lidhje me dakortësinë për mënyren e depozitimit të pasqyrave financiare në AKEP, sugjeron që datat e depozitimit të pasqyrave financiare në AKEP, të jënë të njëjta si për sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike dhe për ofruesit e shërbimit postar.

#### **Sipërmarrësi III:**

Shprehet dakort me qëndrimin e AKEP.

## **QËNDRIMI I AKEP**

Afatet e përcaktuara në ligj nuk mund të ndryshohen me Rregullore, por për tu ardhur në ndihmë Sipërmarrësve/ Subjekteve dhe për të lehtësuar punën operacionale të tyre, kemi përcaktuar datën 15 shkurt, si datë në të cilën mund të dërgohen online, në rrugë elektronike dokumentet financiare ( shih nenin 7/2 të plote).

### **3. A jeni dakort për mbajtjen e llogarive të shpenzimeve të ndara për administrimin dhe mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe atë postar nga ana e AKEP?**

#### **Sipërmarrësi II**

Shprehet se është dakort që llogaritë e shpenzimeve për administrimin dhe mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike të mbahen të ndara nga llogaritë e shpenzimeve për administrimin dhe mbikëqyrjen e tregut postar.

Gjithashtu, në zbatim të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Nenit 119 pika 4, sipërmarrësi kërkon që në përputhje me parimin e transparencës, çdo vit të publikojë, në faqen e tij zyrtare, një përmbledhje të situatës financiare, duke dhënë kostot administrative/shpenzimet dhe të ardhurat totale të krijuara, ku të detajohen dhe listohen respektivisht të ardhurat nga pagesat për mbikëqyrjen e tregut, pagesat për numeracionin dhe ato për frekuencat.

### **Sipërmarrësi III**

Mbështet qëndrimin e AKEP që llogaritë e shpenzimeve për administrimin dhe mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike të mbahen të ndara nga llogaritë e shpenzimeve dhe mbikëqyrja e tregut të shërbimeve postare.

### **QËNDRIMI I AKEP**

AKEP sqaron se në lidhje me parimin e transparencës, mbi bazën ligjore çdo vit ka bërë publike në faqën zyrtare [ëëë.akep.al](http://ëëë.akep.al), raportin për realizimin e treguesve financiarë vjetor.

#### **4. A jeni dakort që sipërmarrësit të mbajnë të ndara të ardhurat nga shërbimet postare dhe të ardhurat nga aktivitetet e tjera?**

### **Sipërmarrësi II**

Shprehet dakort që sipërmarrësit të mbajnë të ndara të ardhurat nga shërbimet postare dhe të ardhurat nga aktivitetet e tjera.

### **Sipërmarrësi III**

Shprehet dakort me qëndrimin e AKEP.

### **QËNDRIMI I AKEP**

Sipërmarrësit kanë shprehur qëndrim të njëjtë me AKEP.

### **KOMENTË SHITESË**

Përveç komenteve ndaj pyetjeve të bera nga AKEP, sipërmarrësi III, sugjeron se: Rregullorja mbi pagesat për mbikëqyrjen e tregut të shërbimit postar të hartohet si një dokument i veçantë dhe i ndryshëm nga Rregullorja mbi pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike, për rrjedhojë këto dy pagesa duhet të trajtohen veçmasi dhe jo në të njëjtën rregullore.

Përcaktimi i nivelit të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike (sipas përcaktimit në nenin 7.3 të Rregullores nr.20, e ndryshuar ) duhet të kryhet me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP si kompetencë legjitime e organit kolegjal dhe jo me akt ( njoftim shkresë) të Kryetarit të Këshillit Drejtues.

### **QËNDRIMI I AKEP**

AKEP shpjegon mbi komentin e sipërmarrësit sh.a:

a)Nëse i referohemi Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ne nenin 24/4, detyrimi i Këshillit Drejtues konsiston në miratimin e rregullores për nivelin e pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut, brenda kufirit prej 0,5%,

b) ndersa referuar Ligjit nr.46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” , nenit 27, nuk rezulton detyrim ligjor për ndonjë miratim të veçantë nga Këshilli Drejtues i AKEP.

Shpjegimi i mësipërm mbështetet edhe, në kuptim të pikes 1 të nenit 8 të ligjit nr.10296, date 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, *“Titullarët e njësive publike, të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efizienzë...”*.

Në lidhje me komentën për të nxjerrë 2 Rregullore të vecanta (për 2 llojet e pagesave të mbikqyrjes së tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut postar), sqarojmë se në bazë të Ligjit nr.46/2015 datë 7.05.2015 Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë, nuk përcaktohet detyrim për nxjerrjen e ndonjë Rregulloreje për pagesat e mbikqyrjes së shërbimit postar.

AKEP, në kuadër të transparencës dhe disiplinimit me rregullime nenligjore edhe për këto elemente, gjykon se duhet të këto norma të shkruara dhe të detyrueshme për tu zbatuar, ashtu siç përcaktohen shprehimisht në Rregulloren e paraqitur për keshillim publik.